



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1026/3 prot.

Tiranë, më 09 . 10 . 2023

V E N D I M

Nr. 193 , datë 09 . 10 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi², është paraqitur ankesa nr. 198 Regj., datë 02.10.2023, e shtetasit A. P, kundër Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me pretendim diskriminimin për shkak të: etnisë, gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore dhe përgjegjësisë prindërore.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultojnë se subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, dhe në një rend kronologjik kohor evidentohet se:

- Ankuesi ka filluar punë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan me datë 01.11.2003, në detyrën Inspektor Profilaksie, deri me datë 31.12.2004.
- Nga data 01.01.2005 – 18.07.2007, ankuesi ka punuar si personel operues, luftues, shpëtues në Stacionin Zjarrfikës të Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) Elbasan.

¹ Në vijim referuar me akronimin LMD.

² Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

- Mbi bazë të propozimit “Për lirim nga detyra”, të Shefit të Sektorit të PMNZSH së Qarkut Elbasan, është propozuar lirimi nga detyra i subjektit ankues, A. P.
- Me vendimin nr. 57, datë 17.07.2007, të Prefektit të Qarkut të Elbasanit, ankuesi është liruar nga detyra në mënyrë të menjëhershme, me motivacionin e ristrukturimit të oraganikës së PMNZSH Elbasan.

Ndodhur në këto kushte, ankuesi duke mos u dakordësuar me vendimin e mësipërm, ka kundërshtuar gjyqësisht largimin e tij nga puna³, dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të pretendimeve të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me Vendimin nr. 2294, datë 08.10.2009 ka disponuar, ndër të tjera:

“Detyrimin e të paditurit Prefektit të Qarkut Elbasan, të paguajë paditësin A. P, me pagesën kalimtare në masën 50% të pagës referuese të muajit korrik 2007, për 2 (dy) vjet.

Detyrimin e të paditurit Prefektit të Qarkut Elbasan, të paguajë paditësin A. P me dëmshpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore .”

Vendimi sipërcituar është apeluar nga punëdhënësi në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me Vendimin nr. 203, datë 05.03.2012, ka disponuar: *“Lënien në fuqi të vendimit civil nr. 2294, datë 08.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.”*

Në ankesën e depozituar pranë KMD-së, subjekti ankues, ndër të tjera, shprehet si më poshtë citohet:

“Jam baba, jam figurë profesionale (inxhinier), jam ushtarak, jam pakicë kombëtare greke, përfundimisht tani jam edhe invalid pune. Do ju lutesha të studioni rastin tim nëse në vlerësimin tuaj përbën diskriminim fakti që, jam një ushtarak të mos marrë direkt pagesën kalimtare dhe sigurimet shoqërore përkatëse të pagesave kalimtare të ushtarakut. Kur jam i kompletuar si figurë profesionale, përse duhet të afirmohem si dështak?!”

Nga përmbajtja e shkresës me nr. 737/1 prot., datë 29.06.2023, të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan⁴, evidentohet situata si më poshtë:

Në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan me nr. 2294 (13-2009-7362), ankuesi ka përfitur dëmshpërblim nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut të Elbasanit, si më poshtë vijon:

³ Me objekt kërkesë-padie:

“- Trajtimin me pagesë kalimtare për tre vjet, për shkak të ndërprerjes së karrierës.

- Dëmshpërblim me dy paga mujore, referuar pagës së fundit, për ndërprerje të menjëhershme të karrierës”.

⁴ Në përgjigje të kërkesës së ankuesit me nr. 737 prot., datë 26.06.2023, me lëndë: *“Mbi përlllogaritjen e Vendimit të Gjykatës Elbasan me nr. 2294 (13-2009-7362).”*

- 50% të pagës referuese të muajit korrik 2007 për 2 (dy) vjet (paga referuese bruto e muajit korrik 2007 ka qenë 37 750 lekë);
- Dëmshpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore;
- Si dhe shpenzimet gjyqësore.

Sipas vendimit të Gjykatës, sa më sipërcituar, A. P ka përfituar:

- 2 paga mujore të menjëhershme (2 x 37 750 = 75 500 lekë)
- 50% të pagës referuese të muajit korrik 2007 për dy vjet (24 paga x 50% x 37 750 lekë = 453 000 lekë.
- Shpenzime gjyqësore = 3 200 lekë
- Pra, në total ankuesi ka përfituar shumën prej 513 700 lekësh dëmshpërblim nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut të Elbasanit.

Në shkresën sipërcituar⁵, Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, informon ankuesin, duke u shprehur se: *“...ju rikujtojmë edhe se, nëpërmjet përmbaruesit ligjor, i cili ka ndjekur ekzekutimin e vendimit tuaj, me shkresën me nr. 201, datë 17.06.2014, kemi marrë konfirmimin për pushim vendimi.”*

Nga akti i mësipërm shkresor, evidentohet se ankuesi i është drejtuar Shërbimit Përmbarimor, i cili ka ndjekur procedurat për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës në favor të ankuesit, dhe se, dëmshpërblimi financiar, sipas përcaktimeve të vendimit gjyqësor respektiv është shlyer nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Referuar ankesës së z. P, ai pretendon se, është diskriminuar nga ana e Prefektit të Qarkut Elbasan, për shkak të: etnisë, gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore dhe përgjegjësisë prindërore, pasi *“nuk kam marrë direkt pagesën kalimtare dhe periudhën e sigurimeve përkatëse, të pagesave kalimtare të ushtarakut”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, për shkaqet sipërcituar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore,*

⁵Shkresa me nr. 737/1 prot., datë 29.06.2023, e Prefektit të Qarkut Elbasan.

përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

I. Lidhur me dokumentimin e provimin e shkaqeve të pretenduara nga ankuesi.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, janë përcaktuar si shkaqe diskriminimi: “*etnia, gjendja arsimore, gjendja shoqërore dhe përgjegjësia prindërore.*”

Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar shkaqet e pretenduara, megjithëse dokumentimi, provueshmëria e tyre i është kërkuar shprehimisht nga Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 1026/1 prot., datë 26.09.2023.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tyre i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, lidhur me mospërfitimin e pagesës kalimtare dhe të periudhës së sigurimeve përkatëse, sipas kësaj pagese.

Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këtë “shkak” apo këto “shkaqe”.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Neni 1, i këtij Ligji, është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së).

Gjatë shqyrtimit të çështjeve me pretendim diskriminim bazuar në shkaqet e parashikuara në LMD, Komisioneri, gjithashtu, i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës, si dhe me shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Referuar sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte shkaqet e pretenduara prej tij.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

II. Lidhur me pretendimin e ankuesit për sa i takon keqzbatimit nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me nr. 203, datë 05.03.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi⁶, rezulton se, pretendimet për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë ai i ka ndjekur sipas procedurës së përcaktuar në ligj, përmes Përmbarduesit Gjyqësor.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbardimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 2⁷, të tij, ka përcaktuar se:

“1. Shërbimi i Përmbardimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Shërbimi i Përmbardimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbarduesve gjyqësorë.”

Pika 1, e nenit 5⁸, të këtij Ligji përcakton se:

“Përmbarduesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.”

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm.”

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

⁶ Referuar shkresës me nr. 737/1 prot., datë 29.06.2023, të Prefektit të Qarkut Elbasan.

⁷ Objekti i veprimtarisë.

⁸ Përmbarduesi gjyqësor.

“ Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbarruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbarruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.”

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbarruesi gjyqësor.

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, përmbarruesi gjyqësor ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të detyrave funksionale, konform përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, të ndryshuar.

- Evidentohet se veprimet procedurale të Përmbarruesit Gjyqësor për ekzekutimin e këtij vendimi për llogari të ankuesit kanë përfunduar që në vitin 2014, dhe se vendim i gjykatës në favor të ankuesit është ekzekutuar.
- Nëse ankuesi do të kishte pasur pretendime lidhur me mënyrën e ekzekutimit/zbatimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës, kundrejt Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, marrja dijani e tij lidhur me këto veprime (apo për veprime e mosveprime të tjera diskriminuese të këtij subjekti/ish-punëdhënësit) i ka lindur që në muajin qershor 2014, periudhë kur është ekzekutuar ky vendim.

Pra, subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e ish-punëdhënësit/Prefektit të Qarkut Elbasan, lidhur me faktin e keqzbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që në muajin qershor 2014, kur është bërë ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Durrës.

- Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka marrë dijeni për keqzbatimin e pretenduar të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Durrës, lidhur me pagimin e pagesës kalimtare, sipas këtij vendimi, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), që në muajin qershor 2014. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 02.10.2023, pra më vonë se dy vite nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese”, ankesa e shtetasit A. P, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues A. P, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA